# DËSHMI ARKIVI

**A-470223**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Goditi me vezë Ramën në New York, Mevlan Mata rrëfen si reagoi Kryeministri dhe çfarë ndodhi me të në komisariat - REPORT.AL |
| ADRESA | `https://report.al/goditi-me-veze-ramen-ne-new-york-mevlan-mata-rrefen-si-reagoi-kryeministri-dhe-cfare-ndodhi-me-te-ne-komisariat/` |
| BURIMI | report.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 20:14:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 20:06:50 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b1acdaae7ddfeeed7258c00a0c71c12cb20d0a38a1d41775638f4e221c52a0c1` |
| TEKSTI | `f18fe8d6c6eb8c9155103ec8e438d6c17d0c1fbb1fee8298ee8a85aab57a0ce0` |
| PAMJA | `ee69b7a1b6419310fb88efc12bff6790e5924f6b0df117698952afa7f161b9ce` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f1f6c9336e3f8220c2933de7c1808f9e4be2360a3c654d4306e5b9485ee98b9f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f1f6c9336e3f8220c2933de7c1808f9e4be2360a3c654d4306e5b9485ee98b9f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Goditi me vezë Ramën në New York, Mevlan Mata rrëfen si reagoi Kryeministri dhe çfarë ndodhi me të në komisariat

by Sport Sport — September 25, 2026 in Aktualitet, Politike

0 SHARES Share on Facebook Share on Twitter

Kryeministri Edi Rama është përballur me protesta nga disa aktivistë shqiptarë gjatë vizitës së tij në SHBA, ku ndodhet për punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Gjatë momentit kur Rama mbërriti në ambientet ku do të zhvillohej një prej takimeve të tij, disa protestues shqiptarë lëshuan thirrje kundër tij dhe e akuzuan me epitete si "mafia" dhe "kriminel".

Në pamjet e publikuara nga ngjarja, një prej protestuesve shihet duke hedhur vezë në drejtim të kryeministrit.

Mevlan Mata, personi që deklaron se ka hedhur vezët, ka rrëfyer në një lidhje direkte me News24 detaje nga protesta dhe reagimin e Ramës.

"Ishim në hyrjen e godinës ku do të mbahej takimi, ku Rama ishte i ftuar. Kishim informacion që ai do të ishte atje, sepse informacioni ishte kudo në rrjetet sociale. Kjo ishte protesta e 10 ose e 11 që nga nisja e protestave në Shqipëri", tha Mata.

Ai pranoi se vezët nuk e prekën kryeministrin, ndërsa shtoi se protesta vijoi pavarësisht reagimit të Ramës.

"Vezët fatkeqësisht nuk e prekën kryeministrin. Do të doja shumë ta kishin kapur. Balla duket se fshihej pas Ramës. Rama vijoi rrugën, është mësuar me shprehjet që ne i thamë dhe nuk i bëhet shumë vonë, por ne bëmë punën tonë dhe do të vijojmë deri në rrëzimin e tij", u shpreh ai.

Mata tha gjithashtu se është shoqëruar për disa orë pas protestës.

"U mbajta në komisariat 2-3 orë, por u sollën shumë mirë me mua. U arrestova nga Shërbimi Sekret, me kërkesë të qeverisë shqiptare", deklaroi ai.

Mata foli edhe për protestat që vijojnë prej 118 ditësh në Tiranë, duke pretenduar se ato kanë sjellë rezultatet e tyre dhe se tashmë protestuesit presin largimin e qeverisë.

"Kam qenë dy herë në Shqipëri vetëm për protestën. Jemi krenarë për popullin që është ngritur në këmbë ndaj të gjithë klasës politike, jo vetëm mazhorancës aktuale. Protesta i ka dhënë frytet, presim aktin final, rënien e qeverisë që nuk ka më asnjë legjitimitet", tha Mata.

Ai u bëri thirrje shqiptarëve që të marrin pjesë në protestat në Tiranë.

"U bëj thirrje shqiptarëve të dalin sa më masivisht në shesh. Se çfarë vjen pas rrëzimit të qeverisë, ju siguroj se ka shumë të rinj e të reja të gatshëm të marrin në dorë fatet e vendit", përfundoi ai.

TË FUNDIT

Goditi me vezë Ramën në New York, Mevlan Mata rrëfen si reagoi Kryeministri dhe çfarë ndodhi me të në komisariat
SEPTEMBER 25, 2026

Arrestimi i drejtueses Vlora Hyseni/ Salianji: S'ka qeveri që qëndron në këmbë pas skandalit të SHISH
SEPTEMBER 25, 2026

Sherr masiv në Korçë, shoqërohen në polici tre persona
SEPTEMBER 25, 2026

Plotësohen vakancat, zgjidhet dhe anëtarja e tretë e Këshillit të Lartë Gjyqësor
SEPTEMBER 25, 2026

Protestuesit dhe studentët sfidojnë shiun! Mbyllen fjalimet te Kryeministria, nis marshimi në rrugët e Tiranës
SEPTEMBER 25, 2026

Aktivisti, thirrje ambasadorit të ri të SHBA: Na jepni një dorë të krijojmë një qeveri të fortë! Po na cenohet sovraniteti
SEPTEMBER 25, 2026

Nga SHISH te shëndetësia, pankartat pikante të protestës së 118-të
SEPTEMBER 25, 2026

Shorti për anëtarin e ri të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shpallet fitues gjyqtari Sandër Simoni
SEPTEMBER 25, 2026

Nga SHISH te shëndetësia, pankartat pikante të protestës së 118-të
SEPTEMBER 25, 2026

Rama nga New Yorku: Biden dhe amerikanët e tradhtuan Hashim Thaçin
SEPTEMBER 25, 2026

Previous Post

**Arrestimi i drejtueses Vlora Hyseni/ Salianji: S'ka qeveri që qëndron në këmbë pas skandalit të SHISH**

Sport Sport

report.al

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT

E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja mbytet në lumin Drini i Zi

0 SHARES

01

Makina 150 mijë euro e Grida Dumës, dhuratë nga Ergys Agasi?! Ja çfarë thonë Lolita dhe Elvi Fundo

0 SHARES

Shkarkohet Ilir Topi/ Ish-drejtuesja e CFO Pharma, Rexhina Bici pritet të drejtojë Fondin e Sigurimeve

0 SHARES

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

© 2025 REPORT.AL

Aktualitet / OP-ED / Politike / Rajon / Showbiz / Sociale / Shëndet / Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.